

AKT-THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR BOREALIS CONSTRUCTION SH.P.K

**Sot me date 01.02.2023 ne pranine e ortakut te vetem Z. Ilir Olldashi
themelohet Shoqeria BOREALIS CONSTRUCTION SH.P.K**

Neni 1 Emërtimi

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është BOREALIS CONSTRUCTION SH.P.K. Ky emërtim është i vetmi i shoqërisë dhe përdoret në të gjithë rregjistrimet, transaksionet, marreveshjet dhe komunikimet e saj me të tretët apo shtetin dhe është i vlefshëm si jashtë dhe brenda vendit.
- 1.2 Shoqëria BOREALIS CONSTRUCTION SH.P.K është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.3 Shoqëria ka vulën e saj identifikuese, në formë të rrumbullakët në të cilën është shkruar BOREALIS CONSTRUCTION SH.P.K
- 1.4 Vula e shoqërisë mund të ndryshojë vetëm me vendimin e asamblesë së përgjithshme.

Neni 2 Ortakët

2.1 Ortakët e shoqërisë në kushtet dhe me të dhënat e mëposhtme:

1. - **Z. Ilir Olldashi**, i biri i Dhimitrit dhe i Bardhylkes, lindur ne Durres me 10/07/1983, banus ne Tirane , madhore , me zotesi te plote per te vepruar , i pajisur me Karte indentiteti I30710060J i cili zoteron 100% te kuotave te shoqerise

Neni 3 Objekti i shoqërisë

3.1 Objekti i shoqërisë në përputhje me legjislacionin aktual tregtar shqiptar do të jetë:

- Ushtrimin e aktivitetit për investim dhe ndërtim objektësh shumë katëshe, rezidenciale, rrugësh, rikonstruksione, punime hidraulike, elektrike, punime gipsi, suvatime, sisteme ngrohje-ftohje etj; Ushtrimin e aktivitetit shitjeblerje, objekte industrial, materiale elektrike dhe hidraulike, social-kulturore, bujqesore, turistike, hoteleri, ujesjellesa, punime restaurime dhe rikonstruksioni, punime të dheut, murature, punime betoni, punime të shembjes, kompletimin me instalime të brendshme të objekteve të ndërtuara, marrjen dhe dhenien me qira të pajisjeve të ndërtimit, të mjeteve të transportit për ndërtim dhe tregtim të tyre. Furnizim, vendosje, shërbime, furnizim-montim panele diellore.



Importim, eksportim dhe tregëtimin e të gjithave llojeve të materialeve, automjeteve me goma dhe zinxhira të tipeve të ndryshme të makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme të karakterit publik, industrial, bujqësor, tregëtar, kulturor, sportive të shërbimeve. Ndertimi i kabanoneve industriale dhe bujqësore të të gjitha llojeve; Tregëtim me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrial, 2 produkteve bujqësore, ushqimore, materiale ndertimi, elektrike, hidraulike, sisteme ngrohje ftohje dhe materiale të sistemit të mbrojtjes nga zjarri, pesticidet, pajisje elektronike, konfeksione Grumbullimi dhe depozitimi i materialeve inerte ndertimore jo të rrezikshme. Në fushën e tregëtisë, import-eksport të mallrave dhe pajisjeve industrial, makinerive, automjeteve e agregateve të industrisë Agro dhe Agro-Ushqimore. Punime elektrike dhe montimi të sistemeve të projektuara elektrike hidraulike, ngrohje- ftohje dhe mbrojtjes ndaj zjarrit. projektim, konsulence për ndertim e zbatim të veprave ndertimore publike dhe private, objekte turistike, ushtarake, kulturi, industriale dhe të veprave ndertimore të të gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar; restaurime në përgjithësi, rikonstruksione veprash arti. Studime urbanistike të të gjitha niveleve; planifikim urban; projektim arkitektonik; projektim strukturash mbajtëse beton arme, metalike; projektim rrugësh të të gjitha niveleve, ura, tunele, nenkalime, autostrada, trase hekurudhore mbi dhe nëntokë, portesh, aeroportesh, heliportesh; projektim linjash dhe sistemesh së prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike: Linja mbitokësore dhe nëntokësore për energjinë dhe telekomunikacionet, centrale; projektim ujësjes, kanalizime, vepra ujëtuajtëse, vepra bonifikuese e ujore, vepra kullimi, impiante vaditëse, diga, dampa, etj; projektim vepra naftësjes, gasjes, etj; projektim fotogrametrik, hartografik, topografik; konsulencë tekniko-ekonomike sipas kategorive dhe nënkategorive të licensave profesionale dhe çdo lloj studimi dhe projektimi, që nuk përmendet me sipër. Studime fizibiliteti. Vlerësime mjedisore, etj.. Çdo aktivitet tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit të Shoqërisë. Aktivitet në fushën e ndërtimit, sigurisë dhe mbrojtjes civile: Hartimi i projekteve të mbrojtjes nga zjarri, relacione teknike përkatëse për të gjitha llojet e ndertimeve si dhe zbatimi i tyre. Hartimi i akteve të ekspertizës teknike për zjarret e rena. Dhenia e asistencës teknike dhe trajnimi i punonjësve për sigurinë. Shërbime ekspertize dhe profesionale të mbrojtjes civile. Import dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë të pajisjeve dhe lendeve që nevojiten për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin. Tregëtim dhe shitje me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme elektrike, hidraulike, elektronike, ndertimi, makineri, automjete 3 zjarrfikëse e pajisje për stërvitje. Mirëmbajtja dhe instalimi i sistemeve për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin. Kolaudime, riparime, mbushje dhe shërbime të pajisjeve dhe mjeteve për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Trajnime dhe kurse profesionale për çdo punonjës në fushën e sigurisë teknike, sigurisë dhe shëndetit në punë, mbrojtjes nga zjarri, përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve zjarrfikëse. Ofrim konsulencë menaxhimi dhe hartimi i dokumentit të vlerësimit të riskut për çdo pozicion pune. Ofrime shërbimesh dhe keshillime për krijimin e sistemit parandalues nga rreziku i rënies së zjarrit dhe planin e evakuimit. Keshilla dhe shërbime të jashtme të specializuara, shërbime shëndetësore, mjeksia e punës, ergonomia, higjiena industriale, aspekte psiko-sociale të punës dhe dhenia e ndihmës së parë. Tregëti të mjeteve dhe veshjeve të punës dhe të veshjeve për mbrojtjen nga zjarri. Sigurimi i organizimit të vendit të punës dhe mjeteve të nevojshme mbrojtëse. Informimi, keshillimi dhe trajnimi profesional i punëmarësve dhe përfaqësuesve të tjerë, integrimi dhe dhenia e keshillimit në përdorimin dhe futjen e



teknologjive te reja, duke vene ne dukje pasojat e tyre per sigurine dhe shendetin e punemarresve. Kurse te formimit profesional ne fushat: Siguria dhe shendeti ne pune. Mbrojtja nga zjarri.Cdo aktivitet tjeter te nevojshem per realizimin e qellimit te Shoqerise. Shitblerje e pasurive te tundshme dhe te patundshme. Asistence reklamimi dhe marketing ne fushen e agjentimit, dizajnit, brandimit, paketimit, publicitetit dhe prodhimit te materialeve publicitare, krijimit dhe publikimit te tyre ne cdo lloj materiali apo forme tjeter reklamuese, si dhe cdo aktivitet tjeter favor te aktivitetit kryesor te percaktuar me siper. Projektim te projekteve dhe instalimeve hidraulike dhe mekanike.

3.2 Përshkrimi i objektit të shoqërisë ka natyrë indikuese dhe jo kufizuese. Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme.

3.3 Shoqëria në çdo kohë mund të ripërcaktojë objektin e saj, ta shtojë apo pakësojë atë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të saj.

Neni 4

Selia e shoqërisë dhe Zyrat e përfaqesimit

4.1 Selia e shoqërisë është në Tirane, ne adresen: Rruga “Eduard Mano”, Pallati Nr.10, Shkalla Nr.1, Ap. Nr.6.

4.2 Veprimtaria e shoqërisë ne tërë territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet nga degët e saj, të cilat funksionojnë në rrethe apo ndarje të tjera administrative te Republikës së Shqiperisë nën drejtimin e Drejtorisë.

4.3 Shoqëria mund te çele degë dhe zyra përfaqesimi të reja jashtë territorit te Republikës se Shqiperisë. Ato hapen dhe prishen me vendim te të Asamblesë së Pergjithshme të saj.

4.4 Asambleja e Përgjithshme mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare te administratoreve të shoqërisë, organizon punën, përcakton mënyrën e funksionimit dhe emëron organet drejtuese dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.

Neni 5

Kohëzgjatja e shoqërisë

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë BOREALIS CONSTRUCTION SH.P.K është pa afat dhe fillon në momentin e regjistrimit të ndryshimeve statutore të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

5.2 Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të Asmblesë së Përgjithshme të Ortakëve me të njëjtin kuorum që përcakton ligji tregtar për ndryshimin e statutit.

5.3.Shoqëria mund të prishet gjyqësisht përpara këtij afati në rastet kur humbet kuptimi moral dhe ligjor i egzistencës së saj apo kur parashikohet shprehimisht në ligj, nëpërmjet kërkesës së çdo aksioneri drejtuar gjykatës.

5.4.Shoqëria mund të prishet edhe në rastin e humbjes së aktivitetit të pasurisë së saj deri në një vlerë sa gjysma e kapitalit aksionar. Në këtë rast zbatohen dispozitat Pjesa V “Shoqerite Aksioneri”,Titulli VII,“Prishja e Shoqërisë” të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”



Neni 6 Kapitali

6.1. Kapitali aksionar i shoqërisë është 1.000 leke (njemije) lekë dhe përbëhet nga 1 (nje) kuota me vlerë nominale secila 1000 (njemije). Të gjitha kuotat e shoqërisë, pavarësisht nga numërtimi, janë të barazvlefshme.

6.2. Numërtimi i kuotave ka vlerë indikative dhe nuk shërben për të treguar përparësinë në shlyerje, tjetërsim apo në likuidim.

6.3. Pronësia mbi kapitalin të shoqërisë është si më poshtë:

- 100% e kapitalit që përbëhet nga 1 kuote me vlere nominale 1000 (njemije) leke qe zotërohen nga ortakët:
- Ilir Olldashi - 100% te kapitalit.

Hartuar ne Tirane, me 01.02.2023

Ne tre kopje.

BOREALIS CONSTRUCTION SH.P.K **Ortak i Vetem i Shoqerise**

Z. Ilir Olldashi

